



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

Nr. 1414 Prot.

Tiranë, më 20.04.2021

Lënda: Kërkesë e përsëritur për kryerjen e hetimeve proaktive mbi keqpërdorimin e të dhënave personale të qytetarëve Shqiptarë dhe të bazës së të dhënave shtetërore nga Partia Socialiste

Drejtuar: STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR (SPAK)

PROKURORISË SË TIRANËS

ORGANEVE DREJTUESE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Tiranë

Për dijeni: OSBE/ODIHR- MISIONI I LIMITUAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

PRANIA E OSBE-SË NË SHQIPËRI

DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI

AMBASADA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

AMBASADA BRITANIKE

AMBASADAVE TË VENDEVE TË BASHKIMIT EUROPIAN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Tiranë

Të nderuar,

Në vijim të shkresës me nr. 1318 prot., datë 12.04.2021, me anë të së cilës kam kërkuar nisjen e hetimeve sa më të shpejta mbi keqpërdorimin e të dhënave personale të qytetarëve Shqiptarë dhe të bazës së të dhënave shtetërore nga Partia Socialiste, ende sot nuk kam një informacion,

nuk jam vënë në dijeni dhe nuk është bërë publike ndonjë deklaratë apo reagim zyrtar mbi masat konkrete të marra nga ana e organeve tuaja për zbardhjen e të vërtetës për abuzimin skandaloz me të dhënat personale të mbi 910 000 qytetarëve të Tiranës.

Si Presidenti i Republikës, kam kërkuar disa herë në mënyrë të përsëritur edhe publikisht, kryerjen e veprimeve hetimore të shpejta, objektive, dhe të pavarura, mbi keqpërdorimin e të dhënave personale të qytetarëve Shqiptarë dhe të bazës së të dhënave shtetërore nga **Partia Socialiste, dhe veprimeve të tjera të paligjshme të lidhura apo që kryhen përmes këtij mekanizmi kriminal¹.**

Kjo çështje po ndiqet me vëmendjen më të madhe, jo vetëm, se lidhet me konsumimin e disa veprave penale nga zyrtarë publikë, përfshirë dhe drejtues të lartë të një force politike; jo vetëm se janë cenuar dhe ekspozuar të dhënat personale sensitive të qytetarëve (që mund të përdoren për veprimtari të ndryshme kriminale, duke cenuar deri sigurinë kombëtare); jo vetëm se mund të ketë impakt direkt në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor; porse dhe reagimi institucional duhet të jetë i përgjegjshëm, përballë cenimit të imazhit të vendit në sytë e partnerëve tanë europianë, me pasoja direkt edhe në integrimin e vendit.

Në datën 18 prill 2021, përmes një letre të hapur, nënkryetarja e Grupit Socialdemokrat në Këshillin Bashkiak të Schëabach në Gjermani², i është drejtuar Kryeministrit për keqpërdorimin e të dhënave personale, duke kërkuar përgjigje, për disa pyetje:

- 1. Cila është procedura konkrete e plotësimit të listës nga Partia Socialiste që ju dretjoni? Nga janë marrë të dhënat e çdo personi konkretisht dhe mbi ç'bazë ligjore është bërë ruajtja në servera e një liste të tillë?*
- 2. Cila është baza ligjore e ruajtjes se tyre ne serverat e njerëzve te lidhur me Partine Socialiste, pa dijenine e individit perkates?*
- 3. Cilët janë personat që kanë urdhëruar përpilimin e kësaj liste dhe ata që kanë administruar të dhënat (ruajtjen, aktualizimin)?*
- 4. Nëse të dhënat janë marrë nga kontaktet derë më derë, pra janë “dorëzuar” vetë, ku ekziston materiali shkrimor i qytetarëve, të cilët lejojnë me firmë marrjen dhe përdorimin e të dhënave personale nga persona të tretë (sipa ligjeve europiane ligjerisht duhet të jetë i dokumentuar pranimi i perdorimit te te dhenave personale nga persona te tjere)?*
- 5. Po nëse qytetarët nuk kanë dorëzuar të dhënat personale që gjenden në këto lista vete (sic pohojne shume prej njerezve që njoh personalisht), nga janë marrë keto të dhena?*

¹ <https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/videos/731988874161816/>

² Mund të konsultohet në të gjitha mediat. Për ilustrim:

<https://www.balkanweb.com/shije-shume-e-keqe-dhe-imazh-i-pariparueshem-politikania-gjermane-leter-rames-per-publikimin-e-te-dhenave-personale/>

<https://newsbomb.al/politikania-gjermane-leter-rames-per-databazen-e-ps-uroj-qe-partia-juaj-te-mos-jete-duke-shperdoruar-pushtetin/>

6. Në lista ka emra njerezish qe mbajne detyren “e patronazhit”. A janë pyetur të gjithë personat në fjalë për këtë, si dhe kujt i është bërë “dorëzimi” i komenteve që lexohen në listat e përpiluara.

7. Kush janë personat që kanë patur dijeni për këto komente/shënime? Çfarë ndodh më pas me to?

8. Vota është E LIRË dhe E FSHEHTË. Si përputhet ky parim madhor i demokracisë me faktin se për çdo pjestar të listës (e theksoj, individ, jo në grup, jo një statistikë e zonës, apo lagjes) është e shkruar e zeza mbi të bardhë preferenca e votës individuale?

Përgjigjet për këto pyetje duhet t`i japë para organeve ligjzbatuese së pari Kryeministri dhe kryetari i Partisë Socialiste shtetasi Edi Rama, së bashku me drejtues të tjerë të kësaj partie, ashtu si dhe drejtues të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Gjithashtu, ditën e djeshme, në datë 19 prill 2021, si President i Republikës, i jam drejtuar publikisht Kryeministrit, për të dhënë sqarime për qytetarët dhe organet e drejtësisë, lidhur me disa çështje që duhet të kishin marrë vëmendjen dhe të kishin përkuar me reagimin e menjëhershëm të organit të prokurorisë³.

Këto pyetje, që i kam adresuar publikisht Kryeministrit, dhe fakti që ai nuk mundet t`u kthejë përgjigje, tregojnë qartë se keqpërdorimi i të dhënave personale të shtetasve shqiptarë të ruajtura në regjistrat publikë shtetërorë, ka autor kryesor Kryeministrin, i cili përmes autoritetit të tij ka urdhëruar shfrytëzimin e këtyre të dhënave për qëllime politike të Partisë politike që ai drejton.

Ky fakt provohet qartë edhe referuar pohimeve të tij në daljet e tij publike përgjatë këtyre ditëve të fundit të fushatës zgjedhore, ku ai personalisht merr në mbrojtje, mbivlerëson dhe justifikon mekanizmin e “patronazhimit”⁴ që sipas tij përdoret nga Partia Socialiste, drejtues i së cilës është ai vet.

Për t`ju ndihmuar në punën Tuaj, po ju përcjell këto pyetje, që do të duhet të gjejnë përgjigje në hetimin që ju po kryeni, duke regjistruar e më pas thirrur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasin Edi Rama, Kryetar i PS, dhe Kryeministër:

³ Deklarata e plotë e publikuar dhe në faqen zyrtare të Institucionit, në link-un:
<https://president.al/deklarate-per-shtyp-e-presidentit-te-republikes-sh-t-z-ilir-meta/>

⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=R3iYv5GP8o0>
<https://www.youtube.com/watch?v=UUNOWurxAo>
<https://www.youtube.com/watch?v=VbnQnq9Slfg>
<https://top-channel.tv/2021/04/17/rama-per-patronazhistet-brenda-ps-te-angazhuarit-punojne-vullnetarisht-kur-te-bjere-bilbili-do-shohin-tabelen-nga-74-78-mandate/>
<https://abcnews.al/rama-reagon-per-patronazhistet-tu-merrni-te-keqen-ju-njohin-mire/>

1. Kur u krijua kjo bazë të dhënash, ku ruhet, dhe kur u popullua (u mbush) me të dhëna në Partinë Socialiste?
2. A janë këto të dhëna të njëjta me të dhënat që çdo qytetar ia ka besuar organeve shtetërore gjatë marrjes së shërbimeve të ndryshme në Portalin Shtetëror E-Albania ?
3. A ka harxhuar shteti shqiptar miliona Euro për tendera për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore dhe ruajtjen e tyre në mënyrë të pacenuar, ndërkohë që vazhdojmë të shpenzojmë miliona euro për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve? Si garantohet siguria e të dhënave elektronike që administrohen në bazat e të dhënave shtetërore që administron AKSHI?
4. Muajt e fundit qytetarët që ushtrojnë aktivitet biznesi janë detyruar të depozitojnë nënshkrimin elektronik/digjital, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe AKSH-it, kundrejt detyrimit financiar prej katër mijë e tetëqind lekësh të reja.
 - Cilat janë garancitë që u ofrohen këtyre qytetarëve në kushtet e administrimit politik të të dhënave të bizneseve?
 - Cilat janë garancitë që u ofrohen qytetarëve dhe sipërmarrësve në kushtet e rrjedhjes masive të të dhënave personale që administrohen në bazat e të dhënave shtetërore?
5. Personalisht, unë, shtetasi Ilir Rexhep Metaj, President i Republikës, nuk kam deklaruar ndonjëherë apo dorëzuar askund pëlqimin tim për administrimin e të dhënave të mia personale për qëllime të mbledhjes së të dhënave dhe përlllogaritjes së rezultateve zgjedhore nga Partia Socialiste. Ndërkohë që në këtë databazë, të bërë publike, gjenden të administruara gjithë të dhënat e mia personale. Kur ky veprim është kryer deri për Presidentin e Republikës, Kreun e Shtetit, çfarë u është bërë të gjithë shqiptarëve me të dhënat e tyre?!
6. Me çfarë të drejte u janë marrë të dhënat personale shtetasve shqiptarë, duke nisur nga numri unik i identifikimit, atësia, mëmësia, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, kodi i banesës, numër telefoni, vendpunësim, dhe me çfarë guximi janë vendosur epitetet dhe komente mbi problemet, qasjen, dëshirat, vullnetin, apo shqetësimet që kanë **910 000 qytetarët e Tiranës?**
7. Me çfarë të drejte u është caktuar shqiptarëve nga një patronazhist, për t`u futur në jetën private dhe personale të tyre, për t`u zbuluar atyre, çfarë dëshirash, apo problemesh kanë, për t`i shantazhuar ata për dhunimin e të drejtës për të votuar?
8. A përbëjnë gjithë komentet e bëra për qytetarët nga ana e “patronazhistëve” diskriminim të shqiptarëve për nga përkatësia etnike, raca, gjinia, feja, etnia, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, duke vendosur në “bazën e të dhënave” të Partisë Socialiste lloj- lloj epitetesh dhe të dhënash skandaloze?
9. Kush mban përgjegjësi, nëse të dhënat e shqiptarëve, mund apo do të keqpërdoren për aktivitet kriminal nga mafia kombëtare dhe ndërkombëtare?
10. A përbën ky ekspozim i të dhënave një rrugë të hapur për krimin kibernetik dhe vjedhjen e identiteteve të shtetasve shqiptarë?
11. Ekspozimi i të dhënave personale të njerëzve të drejtësisë, të ruajtjes së rendit publik, dhe atyre që janë të ngarkuar me ruajtjen e sovranitetit të vendit, a dobëson pozitën e tyre përballë krimit të organizuar dhe shërbimeve të vendeve jo mike?

Kërkoj nga ana juaj hetime të thelluara, duke filluar nga Kryetari i Partisë Socialiste, Edi Rama, drejtuesit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), drejtues të tjerë të partisë socialiste, por edhe të personave të emërtuar në “bazën e të dhënave” të Partisë Socialiste si “patronazhistë”, të cilët gjithashtu janë bashkëpunëtorë në krimin e vjedhjes dhe të keqpërdorimit të të dhënave personale, për sa kohë kanë patur dijeni, akses dhe kanë furnizuar me komente këtë “bazë të dhënash”, për ta përdorur për qëllime të partiake.

Një indicie për të filluar, do të ishte nga marrja në pyetje për të zbërthyer mekanizmin kriminal, të “patronazhistëve” të caktuar për vetë prokurorët e drejtuesin e SPAK-ut dhe të prokurorive të juridiksionit të zakonshëm.

Përmes kësaj letre, ripërsëris thirrjen për një hetim pro aktiv, të shpejtë, objektiv, të pavarur për zbardhjen e të vërtetës dhe vënien e personave përgjegjës para drejtësisë, pasi të dhënat personale, jeta private, të drejtat dhe interesat e shqiptarëve janë në rrezik madhor.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META